

**Procesverbal**  
**Mbledhja e radhës së Këshillit Bashkiak Skrapar**  
**Mbajtur më datë 12.11.2025**

**Ora e hapjes së mbledhjes jashtë radhe sipas njoftimit ora 10:00, vendi i mbajtjes së mbledhjes : Salla e mbledhjeve e Këshillit Bashkiak Skrapar, Qendra Kulturore “Riza Cerova” Kati i Dytë.**

**Listëprezenca e Këshilltarëve pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes.**

1. ALMA KADIASI
2. ARJAN HASA
3. ALBANA HOXHA
4. EDMOND KALEMI
5. ELSA PETRITAJ
6. ERALED ZAIMI m
7. ENVER ÇAKA
8. FIKRET TELHA
9. LIRI NUHELLARI
10. MIMOZA HYSAJ
11. MIMOZA ZYLYFTARI m
12. MYQERRET HEBIBASI m
13. PËLLUMB GURI
14. SKERDILAJT JAUPLLARI
15. VALBONA GROPA m

**Sekretare e Këshillit** deklaroi kuorumin prej 11 Këshilltarësh.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Kryetari i Bashkisë z. Adriatik Mema

Përfaqësues të administratës, të cilët kanë hartuar projekt-vendimet që do të merren në shqyrtim

**Kryetare Këshillit deklaroi hapjen e mbledhjes duke kaluar në pikën 1, miratimi i rendit të ditës sipas njoftimit të bërë me nr. 40 prot. të datës 11.11.2025.**

Kryetare e Këshillit u drejtoi pyetjen nëse ka pyetje, diskutime propozime në lidhje me rendin e ditës.

Këshilltarët shprehin dakortësi me rendin e ditës të njoftuar.

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e rendit të ditës sipas njoftimit.  
Ora 09:00

Vota pro: 11, Alma Kadiasi, Arjan Hasa, Albana Hoxha, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka, Fikret Telha, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

## **Pika 2 deklarimet e konfliktit të interesave**

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka konflikt interesi nga këshilltarët për çështjet që do të merren në shqyrtim.

Për çështjet që do të merren në shqyrtim asnjë nga anëtarët e këshillit nuk ka shprehur konflikt interesi.

**Pika 3 e rendit të ditës “Për transferim buxheti nga fondi emergjencave civile të planifikuara nga të ardhurat e veta, për studim projektim “Ndërhyrje për stabilizimin rrëshqitjes rruga “Hetem Kapinova”.**

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e merr Kryetari Bashkisë z.Adriatik Memai cili prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes?

Me leje fjalën e merr z.Fikret Telha i cili shpreh se është e vërtetë që duhet siguruar ajo rrugë sepse ka rrezik për qytetarët, kalimi i makinave me tonazh më të rëndë dëmton edhe më shumë, ura te vilat është për makinat e vogla do gjejur një zgjidhje.

Me leje fjalën e merr Kryetari Bashkisë z.Adriatik Memai cili shpreh se do studiohet shumë mirë situata për çdo veprim që do bëjmë qoftë për punimet qoftë dhe për kalimin e makinave për të mos krijuar trafik.

Me leje fjalën e merr z.Fikret Telha i cili shpreh se ktu thuhet transferim fondesh ç'farë keni hequr dhe ç'farë keni parashikuar apo nuk i keni harxhuar?

Me leje fjalën e merr z. Neim Gogo i cili shpreh se janë në plam buxheti. Ne pakësuam 604 dhe shtuam 231.

Me leje fjalën e merr z.Pëllumb Guri i cili shpreh se jam lindur dhe rritur këtu dhe e di shumë mirë që ajo do një investim të madh, dhe me që bëhet të bëhet tamam. Jo të bëhet investimi dhe mbas tre viteve të priset prapë.

Me leje fjalën e merr Kryetari Bashkisë z.Adriatik Memai cili shpreh se dua të shpreh diçka e cila nuk më takon mua se nuk jam inxhinjer por di tu them me siguri dhe publikisht se punimet që janë bërë në atë rrugë janë skandaloze. Atje nuk kishte një shufër hekuri dhe as kanale për të qarkulluar ujërat, të vjen keq që të bëhet një punim në atë gjendje, turp ata që e kanë bërë, ata që e kanë superviuar dhe ajo bashki që e ka lejuar. Problemi më i madh që është atje vjen nga lart, rrëshkitja ka ndodhur për shkak se nuk është punuar mirë në pjesën e sipërme. Unë jam duke thënë se projekti do bëhet nga një studio serioze, përpara se të filloi projektuesi do të bëhet studimi gjologjik me sondë, sa metër do shkoj për të përcaktuar nëse do bëhet me beton, me mur mbajtës, do të jetë me pilotë e dinë ata. Ajo rrugë o bëhet o nuk ndërhyet fare sepse sja vlen. Mjafton të siguroi tubacionin e ujësjellësit dhe jamë i larë me atë punë, sepse atje ku nuk bëhet ndërhyrje e thelluar është e kotë që të fusësh duart. Po ta shikoni që nga shpia e Doktor Esatit dhe deri te fusha e sportit çdo dhënie deformimi ka qënë pasojë atij punimi.

Me leje fjalën e merr z.Fikret Telha i cili shpreh se siç kanë qënë ato punime skandaloze, dhe mirëmbajta e bashkisë ka qënë skandaloze. Që kur është marë bashkia nga ju nuk i është vënë dorë asnjë kapak pusete, asnjë hekur, tortuari ka qënë copë – copë. Siç ke rrogulluar tër qytetin rregulloje dhe tortuarin e atij segmenti. Duhej pastruar dhe kanali sipër është i hapur.

Me leje fjalën e merr Kryetari Bashkisë z.Adriatik Mema i cili shpreh se kapakët e pusetave janë atje ndërsa për mirëmbajtjen nuk kamë çfarë ti mirëmbaji dhe tortuari për faji të asaj gjendje është lënë, është e pamundur të bëhej. Kanali është pastruar konsultou me inxhinjerët që e kanë hapur.

Me leje fjalën e merr z.Fikret Telha i cili shpreh se inxhinjer është ai që e ka bërë studimin inxhinjer ai që e ka ndjekur supervizorin inxhinjerët e kanë parashikuar atë rrugë.

Me leje fjalën e merr Kryetari Bashkisë z.Adriatik Mema i cili shpreh se hajde shikoje në çfarë gjendje është, duke hedhur çimendon me lug kafeje.

Me leje fjalën e merr z.Fikret Telha i cili shpreh se punimet tani po prishen brenda ditës punimet që po bëhen. Gjimnazi pa u bërë mirë filloi të pikonte, te pallati djegur këndi i lojrave është prishur.

Me leje fjalën e merr Kryetari Bashkisë z.Adriatik Mema i cili shpreh se derisa punimet janë brenda afatit mbajë unë përgjegjësi, punimet janë më cilësore që janë bërë në të gjithë qytetin.

Kryetare e Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 09:20

Vota pro: 11, Alma Kadiasi, Arjan Hasa, Albana Hoxha, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka, Fikret Telha, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

**Pika 3 e rendit të ditës “Për transferim buxheti nga fondi i investimeve për mbikqyrje dhe kolaudim punimesh në objektin “ Rikualifikim i urës së Çorovodës”.**

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e merr Kryetari Bashkisë z.Adriatik Memai cili prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes? jo

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 09:30

Vota pro: 11, Alma Kadiasi, Arjan Hasa, Albana Hoxha, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka, Fikret Telha, Liri Nuhellari, Mimoza Hysaj, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari.

Vota KUNDËR: s’ka

Vota ABSTENIM: s’ka

**Kryetare e Këshillit e deklaroi përfundimin e mbledhjes .**

**Sekretare Këshillit Bashkiak: Xheni Çela**

**Kryetare Këshillit Bashkiak: Elsa Petritaj**

**Këshilltarët që firmosin procesverbalin:**

1.Alma Kadiasi

2.Fikret Telha

3.Skerdilajt Jaupllari